



PËR PUBLIKIM TË MENJËHERSHËM

5 Qershor 2026

Kontakti: usa250rks@gmail.com

KOMUNA E PRISHTINËS I BASHKOHET PROJEKTIT ZYRTAR TË AMERICA250 NË KOSOVË

Prishtina do të mirëpresë ngjarjen qendrore për shënimin e 250-vjetorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Washington, DC — Projekti “America Inspires Freedom – The Kosovo Story” ka kënaqësinë të njoftojë nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi me Komunën e Prishtinës, duke formalizuar një partneritet strategjik për shënimin e 250-vjetorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë.

Ky partneritet shënon një tjetër moment të rëndësishëm në pjesëmarrjen e Kosovës në shënimin global të America250. Më herët gjatë këtij viti, Fondacioni Shqiptaro-Amerikan nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi me America250, Komisionin e Shteteve të Bashkuara për Përvjetorin Qerekshekullor, duke e bërë Kosovën vendin e parë dhe të vetëm jashtë Shteteve të Bashkuara të përfshirë zyrtarisht në programimin ndërkombëtar për shënimin e 250-vjetorit të Amerikës.

Si kryeqyteti i Republikës së Kosovës, Prishtina do të shërbejë si partner komunal qendror i kësaj nisme dhe do të jetë nikoqire e njërit prej aktiviteteve qendrore të projektit më 2 korrik 2026, duke mbledhur zyrtarë institucionalë, kryetarë komunash, diplomatë, përfaqësues ushtarakë, akademikë, studentë, drejtues të shoqërisë civile dhe mysafirë të shquar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



PROGRAMMING PARTNER



Projekti, me titull “America Inspires Freedom: The Kosovo Story”, synon të kremtojë miqësinë e qëndrueshme ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara, duke vënë në pah kontributin historik të Amerikës në lirinë, paqen, demokracinë dhe shtetndërtimin e Kosovës.

“Prishtina është e nderuar të shërbejë si partner kryesor i Projektit America250 në Kosovë dhe të ndihmojë në shënimin e 250-vjetorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës,” deklaroi Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama. “Pak qytete në botë e kanë përjetuar kaq drejtpërdrejt ndikimin transformues të miqësisë dhe mbështetjes amerikane sa Prishtina. Kjo nismë ofron një mundësi unike për të festuar lidhjen e qëndrueshme ndërmjet dy popujve tanë, duke riafirmuar njëkohësisht përkushtimin tonë të përbashkët ndaj lirisë, demokracisë dhe partneritetit ndërkombëtar. Jemi krenarë që Prishtina do të jetë në ballë të këtij përkujtimi historik dhe do të mirëpresë mysafirë të shquar nga Shtetet e Bashkuara dhe më gjerë në kryeqytetin tonë.”

Në kuadër të marrëveshjes së partneritetit, Komuna e Prishtinës dhe Ekipi i Projektit do të bashkëpunojnë në organizimin e një aktiviteti madhor publik me pjesëmarrjen e mysafirëve të njohur amerikanë, programe edukative dhe aktivitete të veçanta që nderojnë marrëdhënien e jashtëzakonshme ndërmjet Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara.

Faton Bislimi, Themelues dhe Drejtor i Projektit America250 në Kosovë, e vlerësoi këtë partneritet si një mundësi historike si për Prishtinën, ashtu edhe për Kosovën.

“250-vjetori i Amerikës nuk është vetëm një festim i historisë amerikane — ai është gjithashtu një mundësi që qytetarët e Kosovës të shprehin mirënjohjen e tyre të thellë për një miqësi që ndihmoi në formësimin e rrugëtimit të kombit tonë drejt lirisë. Jemi të nderuar të bashkëpunojmë me Komunën e Prishtinës në atë që do të jetë një nga përkujtimet ndërkombëtare më të rëndësishme të America250 jashtë Shteteve të Bashkuara. Si kryeqytet i Kosovës, lidhshipi dhe pjesëmarrja e Prishtinës do të ndihmojnë që ky përvjetor historik të shënohet me dinjitetin, mirënjohjen dhe vizionin që meriton, dhe për këtë i jemi mirënjohës Kryetarit Rama dhe Komunës së Prishtinës.”

Projekti “America Inspires Freedom – The Kosovo Story” po zbatohet nga Fondacioni Shqiptaro–Amerikan si partner zyrtar programues i America250 dhe në koordinim me partnerë në Kosovë dhe në Shtetet e Bashkuara. Aktivitetet e tjera do të organizohen në disa komuna të Kosovës që kanë lidhje të veçanta historike me marrëdhëniet Kosovë–Shtetet e Bashkuara.

###

AMERICA INSPIRES FREEDOM – THE KOSOVO STORY PROJECT

Honorary Co-Chairs: Hon. Joseph J. DioGuardi and Shirley Cloyes DioGuardi | *Founder and Director:* Faton Bislimi

Board Members & Team:

Ramiz Tafilaj | Gino Mulliqi | Shpend Bytyqi | Xhavit Gashi | Shukrije Ramadani | Jusuf Buxhovi | Florentina Dushi

Faton Blakqori | Sherif Sherifi | Xhevat Latifi | Burim Korqa | Shpetim Haziri

www.usa250rks.org



PROGRAMMING PARTNER

